

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Administrativja hapi dyert e thesarit për të rritur rrogat e veta!", reagon Rama: Sikur të kishte të njëjtin st andard për hallet e qytetarëve
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/gjykata-administrative-hapi-dyert-e-thesarit-per-t-e-rritur-rr-i1184869
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 14:22:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 14:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2dab911ccd113ec6dc2e887e77fc12585cbe56db2501ff4dd9bb73eb347fbb56
TEKSTI	43e70382c42458456cebf2192e509832b183ca492c9f15f8d14073171ac0a98c
PAMJA	b82f686ca3278105cb68e0bb1f1cad4cf3031d7f15f0dfc00f75db68c61d0a44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bda882394b97f1fd0ab1de8489df2866e5efd79c9eecf78985eb7f92db57a6c9
E MËPARSHMJA	52fd63ca314cdc5d9628ba4761602fbe3752e798db7176bb58043364d8c7c97e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bda882394b97f1fd0ab1de8489df2866e5efd79c9eecf78985eb7f92db57a6c9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Shqipëria](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim](#)
- [Sport](#)
- [Turizëm](#)
- [Blog](#)
- [Speciale A2](#)
- [Moti](#)
- [Emisionet](#)



“Administrativja hapi dyert e thesarit për të rritur rrogat e veta!”, reagon Rama: Sikur të kishte të njëjtin standard për hallet e qytetarëve

Nga A2 CNN
11 Shtator 2026, 16:20 | [Politikë](#)



“Administrativja hapi dyert e thesarit për të rritur rrogat e

Kryeministri Edi Rama ka reagu në rrjetin social X pas vendimit të Gjykatës Administrative, e cila zhblllokoj pagat për GJKKO-në dhe Gjykatën e Durrësit.

Rama e cilëson vendimin si një veprim të pazakontë, duke kritikuar shpejtësinë me të cilën, sipas tij, gjykata ka ndërhyrë për të mundësuar zbatimin e rritjes së pagave pa miratimin e Kuvendit.

“Sikur Gjykata Administrative të kishte standard për çdo qytetar apo institucion në hall, shpejtësinë e skëterrës me të cilën paska vepruar sot për të hapur dyert e thesarit për rritjen e rrogave të veta pa miratimin e parlamentit, unë besoj se çdo shqiptar i punësuar do ishte gati t’ia falte një gjysëm rroge vrapuesve fluturakë të Gjykatës Administrative”, shkruan Rama.

Kryeministri vijon kritikën, duke e cilësuar vendimin si “diçka tejet turbulluese”.

“Por të marrësh sa hap e mbyll sytë masën e parë të sigurisë në historinë e botës, jo për të ndaluar po për të nxitur për interesin vetjak ekzekutimin e një akti që me gjasë cënon ligjin dhe interesin publik, ndërkohë që mijëra e mijëra dosje hallesh presin me vite në sirtarët e gjykatës në fjalë, kjo është diçka tejet turbulluese!”, shprehet ai.

Rama thekson se, sipas tij, vendimmarrja për hapjen e fondeve të thesarit i takon Kuvendit.

“Ja edhe në tabelën bashkëngjitur çfarë kërkon Gjykata Administrative në dyert e thesarit të shtetit pa kaluar fare nga parlamenti, ndërkohë që e përsëris: Dyert e thesarit të shtetit i hap vetëm pushteti i pavarur legjislativ dhe Kuvendi i Shqipërisë do të bëjë detyrën e tij për këtë temë, në respekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ditën e enjte 17 shtator”, përfundon Rama.

“Administrativja hapi dyert e thesarit për të rritur rrogat e
(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

[Klodiana Spahiu merr detyrën si ministre e Shëndetësisë: Sfida e parë është për besimin](#)

[Makina e re e Kryeministrit, ministrja e Shtetit: Është marrë me qira, e paguan PS](#)

15:36

[“Reforma, shkak që kalova ylberin”, Dash Sula: Asnjë inspektim pa kamera, njoftim e pa kostum](#)

15:13

[Besa “rekruton” Besfortin... Rama largon Lamallarin nga ministria e Brendshme, e zëvendëson me Demon](#)

15:07

[U shkarkua si ministër i Brendshëm, reagon Besfort Lamallari: Mirënjohje Ramës](#)

13:10

[Shtëpi me 60 mijë euro në Tiranë? Ministrja: Ka në periferi, do të jepen 4 mijë kredi të buta, jo për qëllime elektorale](#)

10:41

TE FUNDIT

[Dy javë pas vdekjes së vëllait, ndahet nga jeta Princesha Astrid e Norvegjisë](#)

16:44

[Gjykata merr vendim për pagat, Administrativja pro kolegëve: Ministria t'i paguaj!](#)

16:40

[Votime, grindje dhe krizë pa fund, Kuvendi vijon të dielën, PDK heq dorë dhe pret Kushtetuesen](#)

16:35

[Rusia sulmon sërish Kievin: Dy të vrarë dhe disa të plagosur](#)

16:09

MË TË VIZITUARAT

[Ish-ortaku e kallëzoi, SPAK merr nën hetim deputetin e PD, Luan Baçi](#)

15:14

[Protestuesit e presin jashtë SPAK, Ilir Beqaj paraqitet në GJKKO pas daljes n...](#)

14:47

[Prostitucion në Tiranë, arrestohen 2 vietnameze dhe 1 braziliene](#)

14:43

Live Updates

[Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë](#)

07:28

[LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore](#)

09:08

[Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri](#)

10:52

Latest Videos

 Nuk lejohen me telefona në sallë, avokati: E kemi mjet pune, nuk besoj se bojkoti do zgjidhë....

[Nuk lejohen me telefona në sallë, avokati: E kemi mjet pune, nuk besoj se bojkoti do zgjidhë....](#)

 Deklarata e fortë e avokatit: Rama synon të përplasë gjyqtarët me qytetarët

[Deklarata e fortë e avokatit: Rama synon të përplasë gjyqtarët me qytetarët](#)

 Bojkotuan punën pas vendimit të GJKKO-së, avokati: Ka ngutje, të rishihet rregullorja

[Bojkotuan punën pas vendimit të GJKKO-së, avokati: Ka ngutje, të rishihet rregullorja](#)

 Gjykata merr vendim për pagat, Administrativja pro kolegëve: Ministria t'i paguaj!

[Gjykata merr vendim për pagat, Administrativja pro kolegëve: Ministria t'i paguaj!](#)

- [Shqipëria](#)
 - Aktualitet
 - Kronikë
 - Politikë
 - Ekonomi
 - Sociale
 - Kulturë
 - Moti
- [Kosova](#)
 - Kulturë
 - Sociale
 - Ekonomi



- [Emisionet](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Rajoni & Bota](#)
 - [Ballkani](#)
 - [Bota](#)
- [Argëtim](#)
 - [Showbiz](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Kapur në kamera](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Live Euro 2024](#)
 - [Futboll](#)
 - [Sporte të tjera](#)
- [Speciale A2](#)
 - [5 gjëra në 5 minuta](#)
 - [A2 CNN në Izrael](#)
 - [31 Minuta](#)
 - [A2 CNN në Ukrainë](#)
 - [Lumi i kokainës](#)
 - [Ditari ndërkombëtar](#)
 - [Zbullo](#)
 - [Imagjinatë](#)
 - [Dëshmi](#)
- [Shqipëria](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim & Teknologji](#)
- [Sport](#)
- [Fotolajme](#)
- [Moti](#)
- [Live Updates](#)
- [Speciale A2](#)
- [Emisionet](#)

 [A2 CNN LOGO](#)
[Live TV](#)



[Rreth nesh](#) [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.